

VETËVENDOSJE!

KOPJIMI LEJOHET.
TË LUTEM, KOPJOJE!

GAZETË JAVORE | 9 prill 2007 | nr. 81 | www.vetevendosje.org



Realizëm? Jo, falemnderit!

Glauk Konjufca

Serbia synon kthimin e sovranitetit real mbi Kosovën. Lëvizja VETËVENDOSJE! synon shkëputjen reale të përnjëhershme dhe të pakusht të Kosovës nga Serbia. Pakoja e Ahtisaarit është kompromisi. Ajo është në mes: pakoja realizon ndarjen dhe copëtimin e Kosovës. Grupi i Unitetit e ka quajtur pakon e Ahtisaarit zgjidhje realiste. Edhe shefi i zyres britanike, James Blunt, ka vepruar njëjtë. Ky konstatim është i saktë: pakoja fatkeqësisht është realiste. Ajo zyrtarizon një realitet të krijuar padrejtësisht ndaj popullit të Kosovës. Qe tetë vjet Kosova vegjeton si hapësirë politikisht jounike. Në ¼ të territorit të saj funksionon shteti serb. Në pjesën tjetër UNMIK-u. Pakoja s'bën tjetër veçse aty ku e ka pushtetin Beogradi e institucionalizon këtë kontroll nëpërmjet komunave me shumicë serbe. Kurse në pjesën tjetër na e zëvendëson UNMIK-un me EUMIK. Pakoja e Ahtisaarit njëmend është realiste! Por realiteti është i padrejtë. Politikisht realizmi është ideologjia e të fortit. Në kohën kur Milosheviqi

e mbante Kosovën të okupuar ushtarakisht, zërat që kërkonin pavarësinë e Kosovës i quante kërkesa 'jorealiste'. Njëjtë bënin edhe shtetet perëndimore. Realizmi është ideologjia e raportit të forcave. Kurse idealizmi është dokrina e luftës për të drejtën që të takon, pavarësisht raportit të forcave. P.sh. Veton Surroi dhe Hashim Thaçi janë realistë tipik; Adem Jashari idealist. Por - dorën në zemër! - ka edhe realistë politikisht të pafuqishëm. Këta quhen servilë ose kolaboracionistë. P.sh Grupi i Unitetit. Këta të fundit janë veglat e mbështetjes së realitetit të padrejtë. Në Kosovë kanë qenë idealistët ata që gjithnjë kanë çuar proceset përpara. Në kohën e Jugosllavisë realistët i nënshtroheshin raportit të atëhershëm të forcave, prandaj e tëra që bënin ishte pranimi dhe vetëmjaftueshmëria me aq sa iu jepte Titoja. Realistët rregullisht kanë surfuar mbi sakrificën që e kanë bërë idealistët. Trysnia e madhe e demonstratave të vitit 1968 pasuan me fillimin e zgjerimin relativ të pavarësisë politike të Kosovës përbrenda Jugosllavisë. Pas autonomisë së vitit 1974, realistët vazhdonin avazin e tyre të

servilitetit, kurse idealistët luftën për barazi, për Kosovën Republikë. Realistët në mesin e popullit të pushtuar gjithmonë favorizohen prej pushtuesit. Idealistët njollosen, burgosen, vriten. Por, çdo hap i ri drejt lirisë, idealistët i ngrit në pedestal. Realistët i hedh në koshin e plehrave të historisë. Kështu ka qenë gjithnjë. Kështu do të mbetet sa të ekzistojë gjakimi i popullit për liri e barazi të plotë me popujt tjerë. Realizmi pa forcë është instrumenti i realizmit të padrejtë. Realisti servil i nënshtrohet absolutisht asaj çka vjen prej pushtuesit të fuqishëm. Shumica e atyre që e mbronin autonominë e vitit 1974 si maksimumin e arritshëm politik, ishin po ata që kur Milosheviqi ua mori atë nuk bëzajtën fare dhe e pranuan këtë 'realitet' të krijuar. Sepse ABC-ja e realistit të dobët është nënshttrimi, serviliteti, pranimi i forcës së imponuar. Kulminimi i aplikimit të strategjisë së realizmit ndodhi gjatë viteve '90. Pjesa dërrmuese e spektrit politik të atëhershëm me në krye LDK-në udhëhiqeshin prej kësaj ideologjie realiste. Realiteti i forcave ishte ky: Serbia shumë e fortë, Kosova

shumë e dobët - e pafuqishme për t'iu kundërvënë Serbisë. Por shyqyr që populli ka pasur gjithmonë idealistët e tij që s'iu kanë nënshtruar ideologjisë së raportit të forcave. A nuk fillon epopeja e lavdishme e idealizmit që me Gjergj Kastriotin, i cili i doli përballë një perandorie qindra herë më të fuqishme? A nuk hyn aty edhe Hasan Prishtina, i cili duke qenë i udhëhequr prej gjakimit të lirisë pa kushte, filloi të luftonte madje edhe kundër Perandorisë Osmane, ani pse në anën tjetër e priste Serbia po ashtu më e fuqishme? Në po të njëjtën traditë hyn Shaban Polluzha, Adem Jashari si dhe dëshmorët e UÇK-së, të cilët nuk ditën ç'është raporti i forcave, por vetëm liria që na takon. Kurse realistëve të sotëm, ç'u ka mbetur tjetër përveç se ta pranojnë pakon realiste të Ahtisaarit, duke u zgërdhirë mbi gjakun e atyre që nuk ranë për një realitet si ky i sotmi, po për lirinë e plotë të Kosovës. Deri sot, në Kosovë ka ndodhur që realistëve kolaboracionistë t'ua tregojë vendin e tyre historia. Kësaj radhe atyre duhet t'ua tregojë vendin populli. Siç thonin latinët *hic et nunc!* Tash dhe këtu!

Pa strategji dalëse

Stephen Schwartz

Koha është e zënë në Evropën Juglindore, ku vetëpërrurimi është përzier me ankthin në 50 vjetorin e Unionit Evropian. Rumania dhe Bullgaria prej të cilave asnjëra s'ka ç'të ofrojë drejt institucioneve të qëndrueshme apo zhvillimit ekonomik, tashmë janë shtete anëtare të BE-së. Njëri prej efekteve të para të anëtarësimit rumun qe shfaqja e befasishme e një blloku deputetësh antihebrej, mohues të Holokaustit, në Parlamentin Evropian, duke përfshirë këtu pesë prej të cilëve përfaqësojnë neofashizmin e vazhdtë të Partisë së Rumanisë së Madhe. PRM-ja udhëhiqet prej Corneliu Vadim Tudor-it, një ish poet oborri për diktatorin komunist nga Bukureshti, Nicolae Ceausescu-n. Arritja e pesëshës së GRP-së u dha primitivëve në legjislativin e Evropës mundësinë për të krijuar një grup parlamentar me titullin "Evropa e shteteve kombëtare", ku përfshihen elementet politike tërheqëse si Fronti Kombëtar i Francës, Vlaams Belang të Belgjikës (që përfaqëson interesat e flamanëve), dhe Alessandra Mussolini, mbesa e diktatorit italian.

Rumania arriti hyrjen në Evropë kurse Kroacia, pa ndonjë parti të rëndësishme hebrendërsyese, mbetet e përjashtuar falë kërcënimit politik prej Serbisë, e cila kërkon që para se kroatët të hyjnë në BE, ata të përqafojnë serbët të cilët u lëshuan në një luftë të egër kundër tyre më 1991. Kërcënimi serb dhe dinakëria rumune janë të dukshme gjithkrah. Regjimi i Beogradit agjton kundër çfarëdo forme pavarësinë e Kosovës, kurse policia rumune e cila shërben për UNMIK-un, e shquajti veten duke vrarë dy pjesëmarrës në demonstratën e para dy muajve mbajtur nga një lëvizje e njohur kombëtare e Kosovës, e njohur në shqip si VETËVENDOSJE! (Self-Determination).

Të njëmbëdhjetë oficerët policor rumun u kthyen në Bukuresht edhe përkundër kërkesës së UNMIK-ut që ata të qëndrojnë në

Kosovë përderisa të kompletohet hetimi mbi dy vrasjet. Të rënë, Arben Xheladini (35 vjeçar) dhe Man Balaj (30), u qëlluan prej plumbash të mbështjellur gome. Në po të njëjtën ngjarje, 82 njerëz u lënduan prej zjarrit rumun, nën ngjyrat e autoritetit të KB-së. Dhe, Albin Kurti, udhëheqësi i artikullar i Lëvizjes VETËVENDOSJE! tash ndodhet në burg, i mbyllur në një qeli pa dritare, pa dhomë në të cilën të qarkullonte dhe vetëm me gjysëm ore kohë për të ecur nën dritën e diellit.

Në mënyrë mjaft të çuditshme, 24 marsi shënoi tetëvjetorin e bombardimit të NATO-s mbi Serbinë, e cila kishte për qëllim çlirimin e shqiptarëve të Kosovës prej mizorive të diktaturës së Milosheviqit. Kurse tashmë një dekadë pas, vendi ende vuan prej ndërprerjeve të vazhdueshme të rrymës elektrike, papunësisë mbi 50% dhe përpjekjeve të ringjallura për ta rikthyer atë në sundimin serb. Hapi i fundit drejt këtij qëllimi jolegjitim është diçka që po quhet 'pavarësi e mbikëqyrrur', e rekomanduar prej Martti Ahtisaar-it, i dërguar i veçantë i KB-ve në Kosovë. Nën planin e Ahtisaar-it, hollësitë e të cilit tashmë janë bërë publike, Kosova do të ndahet me pjesën më të madhe të territorit të lënë anash si enklava serbe nën mbrojtjen e OKB-së.

Dokumenti i Ahtisaarit është i vërejtshëm edhe në mënyrën djallëzore të prezentimit të çështjeve të rëndësishme në Kosovë. Problemeve të mëposhtme iu referohet si 'çështje praktike', sikur të ishin ato ca hollësi të parëndësishme lehtësisht të zgjidhshme:

Decentralizimi – që do të thotë kthim i 1/3 të territorit të Kosovës nën Serbi

Të drejtat e komuniteteve – ky është strehim i serbëve nëpër enklava, të qarkuar prej trupave të NATO-s

Mbrojtja e trashëgimisë kulturore e fetare dhe çështjeve ekonomike - kjo do të diskutohet më poshtë. Këto nuk janë 'çështje praktike'. Këto janë punë që definojnë realitetet thelbësore në Kosovë. T'i trajtosh ato si të parëndë-

sishme është më keq sesa absurde.

Në vazhdim të kësaj, memorandum i Ahtisaar-it i referohet 'dhunës' së shqiptarëve 'e kryer kundër serbëve më 1999 dhe mars të vitit 2004' si diçka që paska 'lënë trashëgimi të thellë'. Po çka lidhur me 'trashëgiminë' e dy viteve (1998-99) kur terroristët serbë vranë mijëra qytetarë dhe fëmijë shqiptarë? Çka lidhur me 86 vitet e mëparshme të shtypjes serbe mbi këtë vend?

Që kjo s'që rezultati i pritur kur NATO-ja bombardoi Beogradin, kjo është e kuptueshme. Harta e re e Kosovës së 'pavarur' do të lë burimet kryesore natyrore në duart e serbëve, përfshirë këtu ujë, minierat dhe pasuritë tjera. Përveç kësaj, marrëveshja e Ahtisaar-it deklaroi që, manastiret e krishtera ortodokse të ndërtuara në Kosovë para pushtimit turk në shekullin XIV – objekte të shfrytëzuara për lutje prej shqiptarëve, bullgarëve dhe bashkësive tjera ortodokse të cilat dominonin këtë territor në të kaluarën, por të lëna nga autoritetet osmane nën përgjegjësinë e serbëve për qëllime tagrambledhjeje – janë vendndodhje të trashëgimisë serbe. Pra, më së shumti 5% e popullsisë, me një histori keqtrajtimi mizor të shumicës, do të shpërblehet për dekadat e terrorit dhe përpjekje për gjenocid gjatë viteve 1998-99.

Ambasadori i SHBA-ve në KB, John Bolton, më 24 mars në BBC komentoi se 'Irak do të thotë Jugosllavi në arabisht'. Përderisa ambasadori Bolton qartazi iu referua mundësisë që Iraku mund të ndahej në minishtete shiite, kurde e sunite, shumë më tepër paralele do të mund të tërhiqeshin ndërmjet sunive arab të Irakut dhe serbëve. Në të dyja rastet, diplomacia ndërkombëtare po e mban qëndrimin që persekutuesit e mëparshëm të shumicës së gjerë duhet llastuar në emër të të drejtave të njeriut. Për më tepër, aplikimi i një politike të tillë në Kosovë riprodhon të njëjtën zgjidhje të pamoralshme sikur në Bosnje dhe Hercegovinë, dhe indikon se çka i prët irakianët

poqese Iraku i jipet nën kontroll OKB-së, siç kanë kërkuar disa.

Albin Kurti i burgosur dhe Lëvizja VETËVENDOSJE! kanë probleme serioze me 'projektin' Ahtisaari. Sipas kritikëve, plani i Ahtisaar-it do të bllokojë privatizimin, restaurimin e llogarive bankare të shqiptarëve dhe fondet e pensioneve të cilat janë marrë prej Milosheviqit. Shkresa e Ahtisaar-it me një pafajësi të rreme thotë se UNMIK-u 'nuk ka qenë në gjendje ta zhvillojë një ekonomi të suksesshme' në Kosovë, sikur kjo të jetë diçka aksidentale, ose, për më keq, sikur të ishte faji i shqiptarëve. Por refuzimi i UNMIK-ut për t'u marrë me nevojat ekonomike ishte dhe mbetet një politikë e paramenduar, jo një gjë e rastit. Sipas vizionit të Ahtisaarit, prania ndërkombëtare ende duhet të vazhdojë të operojë me administrimin politik, trupat e jashtëm ende do të ruajnë paqen e lëkundshme, kurse sistemet e shëndetit dhe edukimit, të cilat gjatë tetë vjetëve kanë përjetuar një anashkalim të skajshëm, do të shpërbëhen edhe më tutje.

Po të shprehet pahtazi, nuk ka strategji dalëse të KB-së nga Kosova. Përderisa tragjedia e Bosnje Hercegovinës së ndarë vazhdon të duket e pashpresë, dhe përderisa shumë amerikan janë të bindur nga mediat armiqësore amerikane se Iraku po përkeqësohet për çdo ditë, Kosova e ofron një mundësi për të dëshmuar se procesi shtet-formues ka sukses. Përkundrazi, skema e Ahtisaarit nënkupton ndarje të Kosovës dhe konflikte të reja në Ballkan.

SHBA-të duhet t'i thonë jo 'pavarësisë së mbikëqyrrur' në Kosovë dhe t'i përkrahin aspiratat e shumics shqiptare të cilët kanë besuar se Amerika përkrah demokracinë, ndërmarrësinë, dhe llogaridhënien, kur bombat filluan të bien në Beograd në vitin 1999.

(Stephen Schwartz është korrespondent i shpeshtë i *The Weekly Standard*. Ai është autor i librit *Kosovo: Background to War*)

Kosova 2007: Bukë e Cirkus

Shqiptar Oseku

Gjersa Kosova po rrëshqet drejt humnerës, krerët e fryrë dalldisen të sajojnë gjoja “simbole shtetërore”.

Kësaj jave, ndoshta e ke patur fatin e keq të mësosh për Skicën e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik të Kosovës. Është fjala për një dokument që, në fakt, ravijëzon jo zhvillimin, po thepisen e vendit. Ai fillimisht konstaton se Kosova, sipas të gjitha kriterëve të mundshme ekonomike e sociale, zvarritet larg prapa Ballkanit, pale më Evropës: gjeografikisht jemi në kontinent, por socioekonomikisht ndodhemi në Afrikën Qendrore. Mirëpo, pjesa më rrëqethëse vjen tek më poshtë. Sipas kësaj skice, ekonomia do të vazhdojë të fundoset si sakica në ujë edhe në të ardhmen. Në skenarin absolutisht më optimist, sipas skicës, ndoshta disi kthehemi në standardin e sotëm (!) dikur në vitin 2020. Veçse duhet kapërcyer një problemth. Duhet investuar (vëni re shifrat) 1.6

miliard € nga qeveria, 3 miliard € nga investuesit e brendshëm, e 2.2 miliard € nga investues të jashtëm. E atëhere, sipas skicës, mund t'i vjelim frutat e mundit: Kosova do të ketë varfëri të skajshme veç 8 %, varfëri të përgjithshme veç 25 %, analfabetizëm veç 10 %, mungesë ujësjellësi veç 20 %, e mungesë kanalizimi veç 50 %. Me fjalë tjera, krejt gati për të hyrë në Evropë...

Kryesues i punës për hartimin e kësaj skice paska qenë (sërish) dr. Muhamet Sadiku, një ndër ekspertët më të zotë të vendit në lëmin e ekonomisë. Si dhe, për ata që s'e njohin, një ish. Më saktë, ish Bashkërendues i Sekretariatit për Hartimin e Strategjisë dhe Planit Zhvillimor të Kosovës. Ky sekretariat, që në fakt ishte një zyrë anonime, pothuajse pa personel e pa buxhet, u shua urgjentisht në mbarim të 2006, kur Sadiku gaboi t'ia linte në dorë qeverisë një tjetër skicë, Strategjia Zhvillimore e Kosovës 2007-2013, me përmbajtje pakashumë të njëjtë. Mesazhi i qeverisë që i kthjelltë si loti: kas-

necët e lajmeve të këqija ekzekutohen në vend.

Mirëpo, dr. Sadiku është optimist, e shpreson se qeveria kësaj radhe s'ka si të shmanget. Herën e kaluar, strategjinë e pat përpiluar vetë, me dy-tre ndihmësa. Kësaj here, ai që nga 2 marsi e gjer më 26 mars, e ka ngritur në këmbë gjithë Odën Ekonomike, si dhe Aleancën e Biznesit Kosovar. Ka bërë grupe të fokusit, ka angazhuar dhjetëra ekspertë vendor e ndërkombëtar për të studiuar veçmas çështjet gjinore, arsimore, thjesht s'i ka lënë dy gurë bashkë për të përpiluar një dokument gjithëpërfshirës. Me shpresë, natyrisht, se qeveria s'ka fytyrë ta flak një paralajmërim ku është përmbledhur gjithë dija ekzistuese në Kosovë. Unë për vete, ndjej një simpati buzagaz për këtë njeri që, i pushuar nga qeveria, vazhdon t'i luftojë mullinjët e erës me kryen-çësinë e Don Kishotit.

Veçse, druaj se dr. Sadiku do të ndahet i zhgënjyer. Sepse, qeveria dhe UNMIK-u kanë përvojë në këtë lëmi. Tentime heroike si të zt.

Sadiku kanë bërë edhe tjerë para tij. Strategji për Zhvillimin e Kosovës 2003-2008 pati hartuar edhe Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë nën dr. Ali Jakupin, por ajo u refuzua (!) nga qeveria. Madje edhe një grup ekspertësh ndërkombëtar (ESPIG) është orvatur më herët t'ia imponojë qeverisë një strategji zhvillimore për Kosovën, me të njëjtin rezultat. Shkurt, qeveria dhe padroni i saj, UNMIK-u, s'para e pëlqejnë realitetin. Ata kanë vendosur që më mirë të rrinë pa strategji të zhvillimit, se sa ta kenë një që e nxjerr sheshit dëshitim e tyre kardinal në Kosovë.

Në vend të kësaj, qeveria dhe UNMIK-u preferojnë të merren me aktivitete më të këndshme në kohën e lirë. Si p.sh., të sajojnë gjoja “simbole shtetërore”. Në mungesë të shtetit, ato, në fakt që janë goxha të rëndësishme. Cezari thjesht po na servir prapë “Bukë e cirkus” si para 2000 vjetësh; veçse tash serviret më pak bukë, e më shumë cirk.

Hollywoodi politik

Salih Mehmeti

Në luftë nuk ka zëvendësim për fitore

Dagllas Mekartur, gjeneral i ushtrisë amerikane (1880-1964)

Retrospektiva e sotshme në lidhje me periudhën rugoviste gjatë viteve të '90 nuk bëhet për ndonjë peshim apo gjykim të rolit të saj real, por kryekëput vihet si frymëzim para Ekipit Negociator për dorëlibësi në kompromise kapitale. Në qoftë se një pozicion i caktuar në kuadrin historik, që ka pasur përmasa dëmi nuk korrigjohet drejtë, atëherë i lihet mundësia atij të përsëdytet, ama kësaj radhe me vëllim pakrahasimisht më të madh se ai i dëmit të parë.

Në radhë të parë, duhet përmendur veprimi metodologjik i kësaj doktrine që popullin tonë në kohën kur përreth bëheshin çarje të mëdha, e sprapsi përmes demagogjisë së planifikuar plot me fraza të bujshme e monumentale për durim me zor në pritje të 'ndërrhyrjes' së faktorit ndërkombëtar. Kjo ideologji bjen fundamentalisht ndesh me lëvizjet çlirimtare të popujve gjithandej Jugosllavisë për shkurorëzim nga

tutela e hegjemonizmit beogradas. Koha e domosdoshme e të mobilizuarit sikundër bënin vendet fqinje u shkëmbye tragjikisht me prapaktim për hir të njëfarë 'stabiliteti' e 'paqeje'. Për hatër të 'stabilitetit', deklaronte klasa e atëbotshme politike, duhet qëndruar 'neutral', paçka që vëllimi i dhunës që e ushtronte regjimi serbomadhi rritej dita-ditës. Të qenurit 'paqësor' dhe njëkohësisht joballafaques, nuk të bën fitimtar. Ai është humnerim në robëri. Kurse ballafaqimi real fyta-fyt e mposht edhe më të fortin tiran. Kurse 'pacifizmi' i '90ve përbën momentin fatal të bishtnimit nga organizimi aq shumë i nevojshëm çlirimtar në Kosovë, që s'kishte rreshtur dot që nga nga viti 1945. Kredoja e shumicës së grupeve ilegale shqiptare në Jugosllavi, pavarësisht nga profili ideologjik, ishte e qartë, këmbëngulëse dhe ballafaquese: arritja e realizimit të çlirimit kombëtar dhe bashkimi me Shqipërinë.

'Pacifizmi' po bëhej një makineri rrënuese e rezistencës ballafaquese të popullit. Demonstratat e paharrueshme studentore të tetorit të vitit 1997, ballafaqim i drejtpërdrejtë, ishin përpjekjet e para për liri, e veçmas një thyerje e shablonit zyrtar rugovist.

Gjasat për demonstrata me përmasa gjithëpopullore po rriteshin dukshëm. Profkat për durim, heshtje, paqësim e dëngla të tjera të politikës së kohës po komprometoheshin për vdekje. Organizimi i paktë ndërkombëtar, që ndodhi si rrjedhojë e trasimit për liri përmes luftës së armatosur çlirimtare, përbën momentin e vetëm të Përendimit të hapjes dhe mbylljes së dosjeve për Kosovën. Por hapja nuk është domosdoshmërisht zgjidhja.

Hovi i faktorizimit të popullit shqiptar, nën pushkët e UÇK-së u pre në dysh. Krerët që ia ndalën hovin UÇK-së u bënë apostuj të 'pacifizmit'. Trysnia e vetme serioze e deriatëhershme ndaj botës përendimore nga ushtria çlirimtare u pre. Në rreshtat vijues kemi paraqitur fragmente të shkëputura nga ditari i kohës së luftës të këshilltarit kryesor të ish sekretarës së shtetit amerikan Madelein Albright, James Rubin, i cili në kapitullin 'Si e gjetëm kompromisin', shkruan për mendjelehtësinë e njerit nga 'krerët' e UÇK-së që i zgjati dorën 'pacifizmit': **'Thaçi dhe unë shpejt arritëm në vendin tonë të dashur, prapa kështjellës. Unë ndeza një cigare shumë ngadalë sepse nuk më vinte asgjë në**

mend. Pas një pauze të gjatë, i thashë me gjysmë shakaje se njoh disa producentë në Hollywood që do të mund të dëshironin të bënë një film të jetës së tij. – A do të jem unë personazhi pozitiv apo ai i keqi në film? – pyeti Thaçi. Në ato çaste, atë e thirrën sërish në dhomë për vendimin përfundimtar, por refuzoi të shkojë derisa të merrte një përgjigje nga unë. – Kjo varet nëse do të nënshkruash apo jo, - i thashë, derisa ai po nisej drejt kështjellës. Pas një ore, O'Brien nxitoi në korridor dhe më nxori nga njëra prej dhomave të mbledhjeve. Ai bëri të ditur se Thaçi ka pranuar t'i lejojë Surroit të nënshkruajë marrëveshjen e përkohshme në emër të të gjithë delagacionit shqiptar. Me Surroin dhe O'Brienin në korridor e tëra që na duhej ishte një laps. Andaj ia zgjata Surroit lapsin tim. Ai nënshkroi'. Fjalët e sipërcekura rrëfejnë qartë interesat individuale të këtyre njerëzve që përpigën për lëkurën e tyre personale në 'kinostudiot' ndërkombëtare për arritjen e përjetësisht të emrit të tyre, pavarësisht qysh. Këta janë aktorët e hollywoodit politik në Kosovë.

1989

Deputetët e Kuvendit të Kosovës prapë po hyjnë në histori. Dhe prapë për të keq. Më 23 mars 1989 ata që e quanin veten përfaqësues të popullit të Kosovës i miratuan ndryshimet kushtetuese të Republikës së Serbisë. Në deklarimet e tyre, të vendosura në anën e pasme të këtij trakti, ata i quanin këto ndryshime si jo të dëmshme, madje si bazë për zhvillim të mëtejshëm ekonomik-politik. Kaloi pak kohë dhe qytetarët e Kosovës e kuptuan në lëkurën e tyre këtë zhvillim. Ata u përjashtuan nga puna, u përjashtuan nga Kosova, u vranë, maltretuan, plaçkitën...

Më 5 prill 2007 deputetët e Kuvendit të Kosovës janë mbledhur në të njëjtën sallë për ta miratuar me aklamacion një deklaratë mbështetëse për Pakon e Ahtisaarit. Me këtë Pako na është thënë se Kosova fiton çdo gjë. Njëjtë si më 1989. Ç'është e vërteta me këtë Pako Kosova humb çdogjë, për shkak se e humb integritetin territorial, si dhe trashëgiminë kulturore dhe historike. Më këtë Pako Kosova e humb mundësinë për një qeverisje qendrore funksionale. Me këtë Pako Kosova e humb përfundimisht elementin autokton shqiptarë në të. Rrjedhimisht me këtë Pako Kosova e humb historikun e rezistencës kundër okupimit serb, këtë okupim që u ritheksua më 1989 kur Kosova, siç u tha, nuk humbi asgjë. Kosova ka humbur shumë më 1989 pavarësisht deklarimeve të atëherëshme të deputetëve. Kosova po humb

KMDLNJ viziton të burgosurit në burgun e Dubravës dhe Albin Kurtin në spitalin e këtij burgu.

Më 5 prill, në kuadër të monitorimit të kushteve në qendrat e paraburgimit, burgjet dhe qendrat korrektuese, KMDLNJ vizitoi Qendrën Korrektuese në Dubravë, me ç'rast pati takime me të burgosurit në të gjitha pavijonet (përjashtuar pavijonin I, i cili menaxhohet nga ndërkombëtarët dhe për të cilin duhet leje e veçantë nga Departamenti i Drejtësisë, UNMIK-u). Në këtë pavijon janë duke e vuajtur dënimin kryesisht të dënuarit nga ish UÇK-ja dhe konsiderohet pavijon me trajtim të veçantë. Për vizitë pavijoneve të tjera KMDLNJ është pajisur me leje nga Ministria e Drejtësisë, ndërkaq për viz-

shumë sot pavarësisht deklarimeve të politikanëve. Kosova nuk do të humb vetëm kur të deklarohet populli i saj. Këtë deklaram duhet ta bëjmë të dëgjueshëm tash. Ky deklaram duhet të jetë gjëja e vetme që dëgjohet kur flitet për të ardhmen e vendit tonë. As zëri i deputetëve as ky i politikanëve por vetëm i popullit.

Exhair MURATI

Kjo mbledhje, është rast hiostorik, për shkak të aktit që është në redn të ditës e të rrethanave në të cilat shqyrtohet. Me amandamente në kushtetutën e RS të Serbisë bëhet lëvizje positive përpara nga konstituimi i RS të Serbisë si shtet pa prekur autonominë e krahinave, bile me to zgjerohet hapësira për manifestim të autonomisë plotë të tyre, forcohen të drejtat, liritë dhe siguria e qytetarëve.

Fidai MJEKIQI

Këto ndryshime nuk sjellin në pyetje autonominë e Krahinës dhe pozitën e saj në Jugosllavi, e në të njëjtën kohë duhet të sigurojmë barazi më të madhe për forcimin e vëllazërim-bashkimit të të gjitha kombeve dhe kombësive.

Ymer XHAFIQI

Ndryshimet kushtetuese në kushtetutën e RS të Serbisë u përkrahën në tërësi dhe konsiderojmë se është e arsyeshme që edhe sot të japim pëlqimin për to.

itë Albin Kurtit është pajisur me leje nga gjykatësi ndërkombëtar (leja i jepet vetëm për një vizitë gjatë një muaji). KMDLNJ ka pasur takim edhe me drejtorin gjeneral, zëvendës drejtorin dhe disa mbikëqyrës të kësaj qendreje korrektuese. Për këtë, KMDLNJ do të dalë me një raport. KMDLNJ në Spitalin e Dubravës e vizitoi Albin Kurtin, aktivistin e Lëvizjes për vetëvendosje, i cili kohë më parë, pas grevës së urisë u transferua nga burgu i Pejës. Albin Kurti është nën një trajtim mjekësor pas grevës së urisë dhe kushtet ku tani gjendet janë pakrahasimisht më të mira se në burgun e Pejës. I është lejuar qëndrimi në ajër të pastër dy orë brenda ditës, një orë paradite dhe një orë pasdite. Në dhomën ku gjendet ka televizor dhe mundësi të informimit

Muharrem SYLA

Klasa punëtore, njerëzit punues dhe qytetarët e Mitrovicës së Titos kanë besim se me këto ndryshime krijohen kushte për një zhvillim më të shpejtë shoqëror-ekonomik dhe politik të Serbisë, e në kuadër të saj edhe të Kosovës.

Halit AHMETI

Atëherë ata që shikojnë me turbullue ujin, jo ky kështu, jo ai ashtu më duket se nuk kemi të drejtë. Po dua të them të drejtat e askujt nuk janë shkelë. Po dua me thënë ne ta shikojmë unik Krahinën dhe Republikën e të jemi më shumë prezent në Republikë, t'i zgjidhim problemet.

Muhamet ARIFI

Kur ka qenë fjala për amandamentet në Kushtetutën e RSFJ-së para këtij Kuvendi në këtë foltore kam dalur e kam thënë, përveç tjerash, [se i japim] përkrahje të plotë ndryshimeve të cilat duhet të çojnë përpara.

Flamur GORANCI

U jap përkrahje amandamenteve të harmonizuara në Kushtetutën e RS të Serbisë, të cilin aprovim e konsiderojmë si grusht të rëndë armiqëve të Jugosllavisë dhe skeptikëve të ndryshëm se gjoja ky Kuvend nuk është me orientim nuk është me orientim jugosllav si edhe ndaj mosbesimeve të ndryshme ndaj të gjithë klasës punëtore, njerëzve punonjës të KSA të Kosovës.

Muhamet QORKADIU

Mendoj se opinionit i është e ditur, dhe kjo është bërë e njohur edhe nëpërmjet mjeteve të informimit publik, se Kuvendi [i komunës së Pejës] me datën 21 të këtij muaji i pati në rend të ditës amandamentet kushtetuese dhe i përkrahu ato njëzëri. Kaq.

përmes mediave të tjera. Albini ka patur një infeksion të kanaleve të urinës si dhe gjatë kontrollimit me EHO i janë gjetur tre guralecë në veshkë, dy në njërin dhe një në tjetrën. Përkundër faktit se Albini dukej mirë, KMDLNJ e vlerëson se qëndrimi i mëtutjeshëm i tij në ato kushte, seriozisht do ta dëmtojë shëndetin e tij, andaj kërkon që t'i krijohen kushtet për kontrollim mjekësor dhe trajtim profesional nga urologët dhe nefrologët. Kushtet në Spitalin e Dubravës (ato fizike janë të mira), nuk e mundësojnë trajtimin e duhur dhe shërimin e Albin Kurtit. (Sepse mungon kujdesja profesionale). KMDLNJ u informua nga Albin Kurti se i vetmi fluid që ka përdorur Albini gjatë grevës së urisë ka qenë uji nga ujësjellësi, si dhe e hedh poshtë

Hazër SUSURI

Mendoj se në këtë drejtim duhet të përkrahët propozimi i amandamenteve në Kushtetutën e RS të Serbisë, dhe në këtë drejtim çështjet të cilat janë harmonizuar janë me interes të të gjithë njerëzve punonjës dhe të qytetarëve, e veçanërisht duke patur parasysh se në këtë drejtim me rastin e harmonizimit të propozimit të amandamenteve në Kushtetutën e RS të Serbisë është patur kujdes që RS e Serbisë t'i realizoj funksionet e domosdoshme të saj shtetërore në tërë territorin e Republikës.

Daut JASHANICA

Kryesia e LSPP më 16 mars me plot përgjegjësi, me tërë dinjitetin e vet në mënyrë unanime ka përkrah në tërësi qëndrimin që të jipet pëlqimi në ndryshimin e Kushtetutës të RS të Serbisë.

Avdi TËRMKOLLI

Unë edhe atje [Dhoma Shoqërore-Politike e Kuvendit të RS Serbisë] kam votu për mu aprovua këto amandamente. Edhe sot e përkrahi edhe pse nuk kam drejt votimi.

Rabit REXHEPI

Po votoj për këto ndryshime nga ndjenja e një përgjegjësie politike dhe të një realizmi politik në momentin e pikjërshëm, në mënyrë që ky akt të jetë një urë fillestare e rëndësishme për përpjekjet që do t'i bëjmë në frontin e përbashkët për tejkalimin e situatës shumë të ndërlikuar politike.

Kurtesh SALIHU

T'u japim përkrahje amandamenteve për Kushtetutën e Serbisë, natyrisht duke respektuar edhe rezervat që i kanë pasur tjerët pa të e duke respektuar shumicën në një shoqëri për udhën demokratike të shoqërisë.

spekulimin në deklaratën e Ministrisë së Drejtësisë se ka hyrë në grevë të urisë kinse për servimin e ushqimit me produkte të Serbisë. Edhe fjala fluid, sipas Albinit, (e përdorur në deklaratën e kësaj ministrie) është përdorur me qëllim të caktuar për të shkaktuar huti, ngase nën fluide nënkuptohen jo vetëm uji por edhe të gjitha ushqimet e tjera në trajtë të lëngshme. KLMDNJ apelon që rasti i Albin Kurtit të trajtohet seriozisht. KLMDNJ kërkon që një ekip i mjekëve profesional të angazhohet për trajtimin mjekësor të Albin Kurtit nën vëzhgim të organizatave ndërkombëtare për të Drejtat e njeriut sepse Albin Kurti është i burgosur politik dhe si i tillë duhet të trajtohet.

KMLDNJ, Prishtinë, 5. 4. 2007

Lëvizja VETËVENDOSJE! është komunitet i njerëzve që refuzojnë të nënshtrohen. Ajo synon arritjen dhe realizimin e vetëvendosjes për popullin e Kosovës. Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet edhe për ndryshime radikale shoqërore e politike që do të mundësonin respektimin e të drejtave të njeriut, të drejtave civile dhe drejtësisë sociale për të gjithë dhe secilin në Kosovë pa kurrfarë diskriminimi.

VETËVENDOSJE!

**KOPJIMI LEJOHET.
TË LUTEM, KOPJOJE!**

Rr. "Perandori Justinian" nr. 9
Qyteza Pejton
Prishtinë, Kosovë

038 222 704
vetevendosje@hotmail.com
vetevendosje@yahoo.com
vetevendosje@gmail.com
www.vetevendosje.org